

VENDIM
Nr. 626, datë 30.7.2013

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE TË AKORDUARA NËPËRMJET MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONAVE RURALE (FAZA 2)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 080, datë 23.2.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale (faza 2)”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të akorduara nëpërmjet marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale (faza 2)”, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONAVE RURALE (FAZA 2)
KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

Aneks 3

Aktivitetet e Programit	Financimi (EUR)		
	Shuma totale	Huaja e Bashkëpunimit Financiar	Kontributi lokal
1. Investim Fizik			
1.1 Ndertimi dhe Rehabilitimi i rreth 10 skemave të furnizimit me ujë	1,341,871	1,131,871	210,000
1.2 Sherbime inxhinierike lokale për projektim dhe supervizion	147,170	147,170	
1.3 Kosto Administrative të ADF	110,000	35,000	75,000
1.4 Konsulent Nderkombëtar Zbatimit	126,000	126,000	
1.5 Fond rezerve	59,959	59,959	
Kosto Totale	1,785,000	1,500,000	285,000

*konvertuar me normën e këmbimit 1 EUR=120 Lek
- vit baze për parashikimin e kostove: 2008
- gjitha vlerat neto ndaj taksave